



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1123/1Prot.

Tiranë, më 01. 08.2024

**V E N D I M**

**Nr. 212 , Datë 01. 08. 2024**

Bazuar në nenin 33/11, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në ndryshuar, është regjistruar ankesa nr.31 Regj., datë 07.03.2024, me palë ankuese Sh. N, kundër Shoqërisë Exx Txx Axxxxxx, sh.p.k, me pretendimin për diskriminim për shkak të *orientimit seksual*.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat “a”, “ç”, nenit 33, pikat 11-15 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën dhe i janë ofruar mundësitë, që të jepte shpjegime dhe dokumentacion për ankesën sipërcituar, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte mundësi të shqyrtonte këtë ankesë.

Komisioneri konstatoi se Shoqëria Exx Txx Axxxxxx, sh.p.k, me dijeninë e plotë nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe dokumentet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në vijim të procedurave të shqyrtimit të çështjes, me shkresat: nr. 411/3 prot., datë 28.03.2024 dhe nr. 411/4 prot., datë 16.04.2024, Komisioneri i është drejtuar Shoqërisë Exx Txx Axxxxxx, sh.p.k, duke kërkuar informacion lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Në vijim, Shoqëria Exx Txx Axxxxxx, sh.p.k, pavarësisht faktit që ka marrë dijani 2 (dy) herë, lidhur me shkresat e sipërcituara, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri, në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të një informacioni të detajuar dhe verifikimit të dokumentacionit të kërkuar, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e pafavorshëm të ankuesit Sh. N.

Në këtë kuadër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vijim të shqyrtimit të çështjes, me Vendimin nr. 140, datë 16.05.2024, ka dënuar me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për mosdhënien e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes, Shoqërinë Exx Txx Axxxxxx, sh.p.k.

Gjatë seancës dëgjimore të datës 11.07.2024 të zhvilluar pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe me email e datës 22.07.2024 Shoqëria Exx Txx Axxxxxx, sh.p.k, ka dhënë shpjegimet e nevojshme si dhe ka dërguar pranë Komisionerit, informacionin e kërkuar sipas Vendimit nr. 140, datë 16.05.2024.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 33/11, “..... Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”, Komisioneri arrin në përfundimin se ka në dispozicion informacionin e kërkuar për të vazhduar shqyrtimin e çështjes.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 33/11 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 140, datë 16.05.2024.
2. Vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës nr.31, datë 07.03.2024, të ankuesit Sh. N.
3. Të njoftohen palët për këtë vendim.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

